

## Njoftim

Në zbatim të manualit të Mekanizmit Koordinues Vendor (MKV) për rinovimin dhe përfaqësimin e shoqërisë civile në këtë mekanizëm dhe ne perputhje me **Urdhërin Nr. 348, Datë 29.05.2020** të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, njoftohet fillimi i procesit të zgjedhjes për përfaqësuesit në MKV të:

Persona që jetojnë me HIV/AIDS: 1 anëtar

Pacientë ose ish pacientë me TB (Tuberkuloz) : 1 anëtar

Organizatrat përfaqësuese për MSM, PID (përdoruesit intravenozë të drogës), PKS (punonjëset komerciale të seksit) , përfaqësues të Komunitetit Rom: 2 anëtarë

Shoqatat e Profesionistëve të lidhura me HIV/AIDS: 1 anëtar

Shoqatat e Profesionistëve të lidhura me TB: 1 anëtar

### **Kriteret për Aplikim<sup>1</sup>**

Organizata/Shoqata duhet:

- Të jetë një entitet i ligjshëm, regjistruar në Gjykatë apo institucion tjetër relevant.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperiencë të deritanishe.
- Të zotërojë dokumentacion përshkrues së operimit, që përfshin objektivat, antarësinë, mënyrën e qeverisjes, përzgjedhjen e oficerëve, etj.
- Prova të funksionimit në mënyrë transparente dhe në respektim me ligjin (pagesa e taxave/tatimeve, deklaratat e auditorëve, etj.)
- Është *e dëshirueshme* që të punojë dhe ketë eksperiencë në punën në komunitet, zhvillimin social, advokaci, në fushën e shëndetit, të jetë ose të ketë kapacitetin për t'u shtrirë gjeografikisht me anëtare dhe rrjete organizatash në Shqipëri.

Per personat që jetojnë me HIV/AIDS:

- Të ketë marrë pjesë në aktivitetet e organizuara ne fushen e HIV/AIDS
- Të mbështesë dhe të ndikojë në shpërndarjen e informacionit për komunitetin e personave qe jetojne me HIV/AIDS
- Të jetë i/e disponueshëm për komunikim nëpërmjet telefonit ose korrespondencës në internet.

---

<sup>1</sup> Bazuar në Manualin e Rinovimit të Anëtarësisë së Mekanizmit Koordinues Vendor dhe Politikave Qeverisëse, Seksioni 1, Seksionet 14 dhe 15 dhe Klauzolat Kalimtare (Paragrafët 43, 44 të Shtojcës 1)

Website i MKV: <http://ccm-albania.al/>

Për pacientë ose ish pacientë me TB :

- Të ketë marrë pjesë në aktivitetet e organizuara për ndërgjegjësimin dhe edukimin e TB
- Të mbështesë dhe të ndikojë në shpërndarjen e informacionit për pacientët me TB dhe komunitetin
- Të jetë i/e disponueshëm për komunikim nëpërmjet telefonit ose korrespondencës në internet.

### **Dokumentacioni për t'u dorëzuar**

1. Letra Prezantuese (modeli bashkangjitur)
2. Regjistrimi i Institucionit në autoritetet përkatëse (për OJF Vendimi i Gjykatës)
3. Statuti
4. Vërtetimi i zyrës së Tatimeve për vitin e kaluar
5. CV e institucionit
6. CV e personave që do të jenë përfaqësues (në cilësinë e anëtarit/es dhe zëvendësuesit/es)
7. Dokument që vërteton përzgjedhjen e dy individëve, kandidat për anëtar/e dhe zëvendësues/e të tij/saj nga organizmi qeverisës i institucionit (e.g. procesverbali i komitetit drejtues/bordi)
8. Një deklaratë e institucionit që merr përsipër në vazhdimësi të përfaqësojë, zhvillojë dhe komunikojë me grupin përfaqësues (model bashkangjitur).

Dokumentacioni mund të dorëzohet në shqip apo anglisht, ose i kombinuar.

Dokumentacioni të dorëzohet deri në date **3/07/2020** në një zarf të vulosur tek Zyra e Protokollit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

### **Procesi i zgjedhjes**

Dokumentacioni do të shikohet nga Komiteti i Rinovimit të Anëtarësisë së MKV nga data **6 -8 Korrik 2020**. Gjatë kësaj jave, në rast mungese të ndonjë dokumentacioni, sekretariati i MKV do të kontaktojë me institucionet/organizatat. Në përfundim të këtij procesi, Komiteti i Rinovimit të Anëtarësisë do të shpallë kandidatët që *plotësojnë kriteret* dhe kanë paraqitur korrektësisht *dokumentacionin* e kërkuar. Njoftimi mbi datën, vendin dhe detaje të procesit do të bëhet përmes kontaktimit me email të institucioneve të cilat do të hyjnë në procesin e zgjedhjes. Në këtë fazë, deklaratat e konfliktit të interesit do t'ju kërkohet kandidatëve për anëtar/zëvendësues (Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile në MKV duhet të njihen dhe angazhohen në zbatimin e Politikës së Konfliktit të Interesit , shih Aneksi 5 i Manualit të Rinovimit të MKV dhe Politikave Qeverisëse, Website i MKV: <http://ccm-albania.al/>).

Procesi i zgjedhjes do të zhvillohet për secilin specifikë përfaqësimi përmes votimit të fshehtë. Në rast se paraqiten aq kandidatura sa vendet e përcaktuara, automatikisht institucioni/et përzgjidhet/n. Në rast se më shumë institucione kanë shprehur interes, do të zhvillohet procesi i votimit i drejtuar nga sekretariati dhe monitoruar nga Komiteti i Rinovimit të Anëtarësisë (një votë për veten dhe një votë për një nga institucionet e tjera të pranishme). Institucioni/et me votat më të shumta do të zgjidhen si përfaqësues/e në MKV. Për përfaqësimet me të drejtë për dy vende në MKV (për Grupet në Risk), kur të dy të përzgjedhurit kanë konflikt interesi zgjedhjet do të duhet të përsëriten<sup>2</sup>. Po kështu do të ndodhë për të gjitha grupet në rast se ka barazim votash.

Kështu, institucioni i zgjedhur do të shpallet ditën e zgjedhjes, por njohja e procesit dhe rezultateve të zgjedhjes duhet të aprovohen nga MKV.

### **Shënim i rëndësishëm:**

Në përputhje me Manualin e Rinovimit të Anëtarësisë së Mekanizmit Koordinues Vendor dhe Politikave Qeverisëse , Seksioni 1, Seksionet 14 dhe 15 dhe Klauzolat Kalimtare (Paragrafët 43, 44 të Shtojcës 1), personat që janë aktualisht anëtarë të MKV për një periudhë të barabartë ose më tepër se gjashtë (6) vjet, nuk mund të aplikojnë për të qënë anëtarë në mandatin e ri të MKV (2020-2023).

Website i MKV: <http://ccm-albania.al/>

---

<sup>2</sup> Kriteri i Fondit Global “Jo me tepër se një anëtar brenda grupit përfaqësues duhet të jetë me konflikt interesi”